



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 538 Prot.

Tiranë, më 12.11.2024

**URDHËR**

Nr. 32, datë 12.11/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PËRCAKTIMIN E  
PROCEDURËS SË INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I RREGULLT  
ADMINISTRATIV”, MIRATUAR ME URDHRIN NR. 25, DATË 10.08.2018, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;

**URDHËROJ:**

1. Në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

*“Në aneksin 1 të rregullores, formati standard nr. 11, “Vendim i Komisionit të Ankimit”, zëvendësohet me formatin standard me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij urdhri.”*

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore dhe/ose strukturat përgjegjëse të inspektimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**INSPEKTORI PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**



Formati nr. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA XXX  
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX  
DREJTORIA RAJONALE \_\_\_\_\_

VENDIMI  
I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Emërtimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit \_\_\_\_\_

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar, të cilit i referohet vendimi përfundimtar (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, "Për krijimin dhe organizimin e ISHP" dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, i subjektit \_\_\_\_\_ (emërtimi i subjektit që është ankuar) (kjo pjesë plotësohet nga sistemi).

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë \_\_\_\_\_

(shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ/citimi i dënimit kryesor dhe plotësues sipas vendimit përfundimtar të inspektimit kundër të cilit është bërë ankimi), Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit arsyeton \_\_\_\_\_

Në konkluzion, Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit, si dhe morri në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar pranë \_\_\_\_\_

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar

☐

2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar

☐

3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar

☐

4. Mospranimin e ankimit

☐

*(Në printim të shfaqet vetëm opsioni që ka vendosur Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit)*

**KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT**  
(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

1. KRYETARI

*(Nënshkrimi dhe vula e institucionit)*

2. ANËTAR

*(Nënshkrimi)*

4. ANËTAR

*(Nënshkrimi)*

3. ANËTAR

*(Nënshkrimi)*

5. ANËTAR

*(Nënshkrimi)*

Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.